



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:043801

Datë: 30.07.2019

Numri i dokumentit: 00433850

P nr.1050/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues, Elmaz Zenuni, me Sekretaren juridike Diellza Krasniqi(praktikante), në çështjen penale kundër të pandehurit F.L nga Ferizaji, Rruga pa nr., për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së , sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.1496-10/2018 të dt.08.08.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 30.07.2019, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit, Avdullah Abedini, të pandehurit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, e poashtu me datën 30.07.2019, me shkrim e përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, **F.L** nga Ferizaji, Rruga pa nr, i lindur me në, nga i ati I.... e ëma B..... e vajzërisë B....., punon si në, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,-

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 12.07.2018, rreth orës 00:45, në Ferizaj në Rrugën, gjatë kontrollës nga Njësia Patrulluese Policore në Ferizaj te i pandehuri në veshjet sportive janë gjetur sasi me substanceë narkotike të llojit mariuhanë , të cilat i ka poseduar pa autorizim me peshë 1.60 gram e që substanca narkotike i është sekuastruar nga ana e policisë,-

Me të cilën ka kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së .

Gjykata, në kuptim të neni 275 par.1, dhe nenit 4, 17, 23, 41, 43, 46, 49, 51, 52, 74, 75, 76 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin, e :

G J Y K O N

I SHQIPTOHET DENIM ME GJOBË në lartësi prej 200 euro me shkronja (me shkronja:dyqind euro), të cilën gjobë i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Njëkohësisht të akuzuarit:

I vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën prej 2 (dy) vite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara nga nenin 46 par.3 të KPRK-së, gjykata do ta ekzekutoj akgjykimin në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 20 € të gjobës të vuaj në një ditë burgu.

Konfrom nenit 275 par.3 të KPPRK-së konfiskohet në mënyrë të përherëshme substanca narkotike të llojit maruhanë me peshë 1.60 gram.

Obligohet i akuzuari F.L, që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj kësaj gjykate shumën prej 20 /njëzet/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmëris së katgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimet –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimet të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/II nr. 1496-10/18 të dt.08.08.2018, e ka ngarkuar të pandehurin, F.L nga Ferizaji, Rruga pa nr., , për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së .

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së PTH-së, me datën 30.07.2019, mbajti shqyrtimin fillestar, ku prezentuan prokurori i shtetit Avdullah Abedini i cili ka lexuar akuzën dhe ka mbetur në tërësi pran kualifikimit juridik të veprës penale. Në shqyrtim fillestar ka marrur pjesë edhe i pandehuri.

Konform nenit 246 të KPPRK-së, të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, përkitazi me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit,

janë pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë
- Pranimi është bërë vullnetarisht.
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe atë: Raporti i Ekspertimit të Agjencisë fushore nga Drejtoria e Trafikimit të drogave i datës 16.07.2018, Vërtetimi për sekuestrimin e sendeve i dt. 12.07.2018, fotografitë e dëshmisë si dhe provat material të cilat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

I akuzuari F.L në shqyrtimin fillestar në fjalën e tij në kuptim të mbrojtjes ka deklaruar, pasi e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që e ngarkon prokuroria është penduar thellë për atë që e ka kryer, por thekson se nuk ka mundur ti kontrolloj veprimet e veta në atë moment i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, kërkon falje për këtë veprim të vetin dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së dënimit si rrethana letësuese ti ketë parasysh theksësimet e sipër theksuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë ekzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve , substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPPRK-së.

(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqyrtimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshtë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se i pandehuri ka pranuar fajsinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të ketë qenë e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, pendesën për veprën e kryer, ka kërkuar falje për veprimet e ndërmmarrura, i moshës relativisht të re, i pa martuar, duke qenë e bindur se në rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet, dhe një dënimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrethanave të kryerjes.

Gjykata, të pandehurit F.L, konform nenit 46 par 1e 2 të KPPRK-së, i shqiptoj një dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro, ashtuqë konform 46 par.3 të KPRK-së, gjykata do ta ekzekutoj aktgjykimin në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 20 € të gjobës të vuaj nga një ditë burgu nëse nuk e paguaj gjobën e shqiptuar sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata të pandehurot i shqiptoj një dënim me kusht në kuptim të nenit 51 e 52 të KPRK-së, duke marrë parasyshtë shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vepra penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së është e sanksionuar me dënimin kumulativ dhe ate dënimin me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) viteve e deri në 3 (tri) vjet burgim, por gjykata

aplikoi nenin 52 par.2 të KPRK-së duke zbutur në minimumin e denimit e shqiptuar në 1 vjet burgim.

Gjykata, zbnutjen e denimit për të akuzuarin e aplikoi dispozitën ligjore të nenit 75 par.1 nënpar.1.3 të KPRKsë, ashtuqë konform nenit 76 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, pastaj nenit 74 par.3 nënpar.3.3, 3.6, 3.8, 3.10, 3.11 dhe 3.12 të KPPK-së, e zbuti denimin nga kriteret, ato kushte janë:

- rrethanat personale të akuzuarit(asnjëherë nuk ka rënë në konflikt me ligjin),
- mosha e personit të akuzuar relativisht e re, i pa martuar,
- bashkëpunimi i të akuzuarit me gjykatën dhe organet tjera të ndjekjes,
- pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit,
- sjellja e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale
- substancia narkotike është sekuastruar nga ana e organeve kompetente.

Gjykata, gjeti se ka bazë të mjaftueshme për zbutjen e denimit me burg siqë është paraparë me ligj, pra në minimumin ligjor dhe ate nga 1 vjet burgim , i cili denim nuk do të ekzekutohet nëse gjatë periudhës së verifikimit në afat prej 2 (dy) viteve i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale.

Gjykata, konstatoi se pas aplikimit të dispozitave të zbutjes së denimit në minimumin ligjor të paraparë me ligj dhe ate nenit 74 dhe 75 të KPRK-së, janë plotësuar kushtet ligjore të dispozitës ligjore të nenit 52 paragrafi 2 dhe 5 të KPRK-së, për shqiptimin e denimit me kusht nga neni 51 i KPRK-së.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave duke i caktuar denim më të butë dhe ate denim me gjobë në lartësi prej 200 eurove.

Nëse i denuari nuk e paguan gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i akuzuari do ta vuaj denimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të denimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Njëkohësisht, të akuzuarit gjykata i ka shqiptuar edhe deniumin e kushtëzuar në kohëzgjatje prej 1 vjet burgim , i cili denim nuk do të ekzekutohet nëse gjatë periudhës së verifikimit në afat prej 2 (dy) viteve i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Konfrom nenit 275 par.3 të KPRK-së konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike të llojit maruhanë me peshë 1.60 gram.

Mbështetur në nenin 450 dhe 451 të KPPRK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 20 €, i cili është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të të akuzuarit, dhe çështjen penale të zhvilluar.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

P nr.1050/2018 të dt.30.07.2019

**Sekretarja juridike,
Diellza Krasniqi (praktikante)**

**Gjyqtari,
Elmaz Zenuni**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.